



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, mbajtur më 25.11.2020, e cila filloj në orën
15:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Bashkim Beha (PSD), Adrian Berisha (PSD), Visare Gashi (PSD), Leonora Shabani – Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Egzon Azemi (LVV), Naim Hoxha (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete (PDK), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Ajeti (AAK), Migjen Shala (PDK), Kreshnik Smajlaj (AAK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK) dhe Sami Boroci (AKR).

Munguan: Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Drilon Pireva (PSD), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Ajeti (AAK), Migjen Shala (PDK), Kreshnik Smajlaj (AAK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK) dhe Sami Boroci (AKR).

Të pranishëm ishin edhe: Muhedin Nushi, nënkyrytar i Komunës, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Dren Kukaj, drektor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Bujar Gashi, drektor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Vasilika Zotaj, drejtore e Drejtorisë së Administratës, Fitim Rexha, drektor i drejtorisë së Sportit, Valbona Osmani, drejtore e Drejtorisë së Kadastrit, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Kryesuesi konstataoi se njëzëri më 35 vota për, u mirtua ky

R E N D D I T E:

1. Propozimvendimi për subvencionimin e qytetarëve të Komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19.

Faqe 1 nga 3

Kryesuesi hapi diskutimin

Muhedin Nushi, nën kryetar i Komunës, tha se me këtë vendim që sot do ta merr Kuvendi i Komunës, përfitues do të janë 13.648 persona, të cilët janë të infektuar deri në ditën e njeshme. Në bazë të këtij vendimi të gjithë ata persona të cilët janë nën moshën 65 vjeçare, përfitojnë nga 50 euro, personat që janë 65 dhe mbi moshën 65 vjeçare përfitojnë nga 100 euro. Përfitues të këtyre mjeteve do të janë të gjithë ata persona që janë në listën e IKSHP-së, pra nuk do të janë ata të tjerët të cilët janë të infektuar, por që nuk figurojnë në listën e IKSHP-së.

Halim Halimi tha se ne si grup e përkrahim këtë propozimvendim, por mendoj se shuma prej 50 euro është e vogël, nuk i mbulon shpenzimet për shërimin e COVID-19, nuk i përbushin as nevojat minimale për shërimin e sëmundjes.

Po ashtu, në këtë situatë shqetësuese është edhe gjendja e disa arsimtarëve në disa shkolla, të cilët lëngojnë prej sëmundjeve të ndryshme kronike, e që me vështirësi i mbajnë mësimet. Pse nuk zëvendësohen këta arsimarë, kur e dijmë se për zëvendësimin e tyre është një linjë e caktuar buxhetore.

Vala Peshku tha se ne pa asnje dyshim e përkrahim këtë propozimvendim, andaj kisha uruar që mos të kemi nevojë të sjellim kësi vendime, ta shohim një përfundim të kësaj pandemie.

Naim Hoxha shprehu mendimin se Komuna më mirë është me i rehatuar të varférítë, sesa me iu dhënë në mënyrë uniformë të gjithëve, por nëse nuk mundemi edhe kjo është mirë. Po ashtu, është dashtë të përfshihen edhe në listë familjet e atyre që kanë pasur raste të vdekjes. Në përgjithësi, mendoj që ky është një vendim i mirë. Po ashtu, mendoj se politikanët dhe ministrat, të cilët janë prekur nga COVID-19, nuk do të duhej të përfshiheshin në listë që t'i marrin nga 50 euro.

Kumrije Shabani theksoi se shuma e propozuar prej 50 euro është e vogël, megjithatë e pëershëndeti këtë iniciativë të kryetarit, e cila më pas shtoi se kjo është vetëm një lëmoshë, kjo nuk është kurfarë ndihme që këtyre patientëve do të iu ndihmonte, prandaj ju lus të gjithëve që në të ardhmen kjo shumë të ngrihet dhe t'iu ndihmojmë njerëzve që kanë nevojë të trajtohen në mënyrë të duhur.

Arbenita Murseli u shpreh në përkrahje të këtij propozimvendimi për ndarjen e subvencioneve nga 50 dhe 100 euro. Kjo është një nismë e mirë sa i përket Komunës së Prishtinës, ani pse të gjithë e kemi parasysh që kjo nuk është një shumë e mjaftueshme, edhe pse kjo është përgjegjësi e nivelit qendror. Mendoj që si Komunë është më e pakta që mund ta bëjmë për t'iu ardhur në ndihmë qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Fiknete Bejtë tha se ne si asamblistë do ta përkrahim këtë propozimvendim, edhe pse shuma është e vogël, mirépo këto janë mundësitet prej Kuvendit të Komunës së Prishtinës. Shpresoj që kjo iniciativë e Kuvendit të jetë edhe një shembull i mirë për Kuvendin qendror, që të sheh unititetin në Kuvend komunal, që edhe ata ta votojnë pakon për rimëkëmbje ekonomike, e cila do të ishte një mundësi më e mirë për qytetarët.

Shefqet Osmani u shpreh se ky propozimvendim është në kohë të duhur, edhe pse vlera është minimale. Ai kërkoi të dijë se lista e Komunës edhe e ordinancave të Komunës së Prishtinës, a është e lidhur me listën e IKSHP-së, kur e dijmë se shumë qytetarë që kanë

qenë të prekur nga COVID-19, të paktën kanë pasur antitrupa, a janë të evidentuara diku këto lista apo jo?

Fadil Gashi tha se edhe ne si grupi i AAK-së e përkrahim këtë iniciativë, kështu që kishte qenë mirë nëse ka mundësi që kjo shumë e mjeteve të jetë më e madhe, sepse shuma e mjeteve prej 50 euro konsideroj se është e vogël.

Shefki Gashi ishte i mendimit se shuma e propozuar prej 50 euro është e vogël për mbulimin e shpenzimeve në rast të shërimit nga smundja, prandaj duhet të mendohet për Spitalin regional të Prishtinës, sepse është gjëja më e nevojshme që i duhet Komunës së Prishtinës. Pacientët e Prishtinës më së keqi trajtohen nëpër klinika të ndryshme dhe se ky buxhet i cili po shpenzohet kështu, është duke u bërë buxheti për mos me u tërhequr grandet dhe nuk e dijë se çka kishin me më kryer punë 50 euro kur të kisha pasur COVID-in-19.

Edhe përkundër vërejtive dhe sugjerimeve që i kisha rrerth këtij propozimvendimi, e përkrah këtë ide, këtë ndihmë solidare minimale.

Arbër Vokrri theksoi se përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve që ne i kemi, e mbështesim këtë iniciativë dhe e falënderoj nënkyetarin për shpjegimet shumë të vlefshme lidhur me të prekurit nga COVID-19. Kisha sugjeruar që ta kemi parasysh, se pothuajse rreth 80% e rasteve më COVID-19, janë asimptomatikë, ose kanë fare pak simptoma, edhe mundën me përballuar infeksionin më një paracetamoll dhe vitaminë c deri në fund, por 20% e rasteve shpenzojnë më shumë, ndoshta ia vlen më menduar për të ardhmen si me i shpërndarë këto mjete më mirë.

Adrian Berisha tha se sa i përket këtij propozimvendimi, ne duhet të kemi mendim racional, p.sh. nëse për mua nuk janë asgjë 50 euro, për ndonjë familje me gjendje të rëndë sociale të cilat do të ndihmohen edhe me një pikë shtesë, janë goxha shumë.

Gjithashtu shtoi se është mirë me bërë thirje njëzëri, që të gjithë ata të cilët janë në kushte ekonomike të mira, mos me aplikuar përfond social, pra të jemi më human në këtë aspekt.

Mimoza Sylejmani tha se që nga fillimi i pandemisë kam qenë pjesë e shtabit emergjent dhe se prej momentit kur është publikuar në rrjetet sociale propozimi prej 50 euro, nuk kanë pushuar së ndaluri telefonantat që për këtë shumë të mjetetve ka pasur shumë të interesuar, kështu që nuk është shumë e madhe, por është një ndihmesë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha **Muhedin Nushi**, nënkyetar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 38 vota përfundoi në orën 15:40.
u miratua Vendimi për subvencionimin e qytetarëve të Komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19.

Mbledhja përfundoi në orën 15:40.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Faqe 3 nga 3

Kryesuesi i Kuventit
Agim Kuleta

